



Prania / Dorezimi Komuna e Presidencës Seçimi / Detyrimi	15.02	2022	2	viti god year
Organ / Mjeshtër Organ / Detyrimi / Org / Unit	No Prof Prof No	Shtojta Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSTOK	800/2022		1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.80/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari dhe Jeton Koca anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.05/2020, të datës 06.01.2020, të ankuesit _____, nga sipas Aktgjykimit A. Nr.94/2020 të datës 02.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative, kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 15.02.2022, mori këtë;

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A. Nr.05/2020 e datës 06.01.2020, e ankuesit sipas Aktgjykimit A. Nr.94/2020 të datës 02.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ me datë 06.01.2020, me numër protokoll 18/2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën „Zyrtar Financiar“, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare „Dr. Shpetim Robaj“, në Malishevë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.01.2020, me numër protokoll 67/2020, ankuesin _____ e ka njoftuar se për shkak të mungesës së korumit të Këshillit nuk mund të vendos lidhur me ankesën A. nr.05/2020, e datës 06.01.2020.



Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 06.01.2020, të Këshillit ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 02.12.2021, ka nxjerr Aktgjykimi A. nr. 94/2020, me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit si të bazuar në ligj, duke e anuluar njoftimin e datës 10.01.2020, të Këshillit, si dhe duke e detyruar Këshillin që të vendos lidhur me ankesën A. nr. 05/2020, e datës 06.01.2020, e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 05/2020, e datës 06.01.2020, me numër protokoli 18/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 07.10.2019, me numër protokoli 599/201, i Inspektoratit të Punës; Njoftimi i datës 13.07.2021; Vendimi i datës 26.06.2019, i Inspektoratit të Punës Ankesë e datës 28.05.2019; Vendimi i datës 21.05.2019, me numër Protokoli 203/, i Komisionit i Ankesave;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e palejuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjarë „Dr. Shpetim Robaj“, në Malishevë, zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Zyrtar Financiar“, e ka bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat ka konstatuar se ankesën ankuesi e ka parashtruar jashtë afatit ligjor.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ankuesi ankesën e ka parashtruar jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesave, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, sepse ankesën e ka parashtruar në KPMSHC me datë 06.01.2020, e cila është regjistruar me numër protokoli 18/2020, ndërsa me ankesë ankuesi ka goditur vendimin e datës 21.05.2019, të Komisionit Ankesave të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjarë „Dr. Shpetim Robaj“, në Malishevë, e që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar lidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*, si dhenë kundërshtim edhe me aktin nën ligjor gjegjësisht neni 11 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili përcakton se: *“Kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditësh”*.

Kolegji, si rrethan faktike dhe ligjore vendimtare për hudhjen poshtë të ankesës ka marr faktin se ankuesi ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë afatin lidhur me paraqitjen e ankesës.



Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr.80/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Gjyqtares
- Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjarë „Dr. Shpetim Robaj“, në Malishevë
- Arkivit të KPMSHCK-së